

*“Deri sa mos ta ndryshojnë (pozitivisht)
gjendjen e tyre”*

MJETET E VENDOSMËRISË NË FENË E ALLAHUT

Profesor:
Amr Halid

Për botuesin **ERIXH LIN-NESHRI**

Autor:

Prof. AMR HALID

Titulli i origjinalit:

وسائل الثبات على دين الله

Titulli:

MJETET E VENDOSMËRISË NË FENË E ALLAHUT

Përktheu:

Dr. Musli VËRBANI

Korrektor:

Burim Bunjaku

*Radhitja kompjuterike,
kopertina dhe dizajni grafik*

Mumin Shehu

Kaçanik

2006

Të drejtën e ribotimit e rezervon botuesi

Hyrje

Vërtet çdo falënderim i takon vetëm Allahut, prandaj ne vetëm Atë e falënderojmë, vetëm prej Tij ndihmë kërkojmë, nuk kërkojmë udhëzim tjetër pos çka na udhëzon Ai, Atij i kërkojmë falje, i mbështetemi Allahut nga të metat tona dhe nga të këqijat e veprave tona. Cilin e udhëzon Allahu, ai nuk humb kurrë, mirëpo cilin e humb Allahu, për të nuk ka udhëzues.

Përsëritës dhe dërgojmë salavate për më të mirin e krijesave, më të zgjedhurin dhe më të ndriturin - robin e Allahut dhe të dërguarin e Tij - Muhamedin a.s.. Përsëritës edhe familjen e tij të mirë dhe të pastër, shokët e tij të mirë dhe të pastër në përgjithësi, dhe ata të cilët i pasojnë gjurmët e tyre me mirësi deri në Ditën e Gjykimit.

Vërtet çdo falënderim i takon vetëm Allahut, prandaj ne vetëm Atë e falënderojmë, vetëm prej Tij ndihmë kërkojmë, nuk kërkojmë udhëzim tjetër pos çka na udhëzon Ai, Atij i kërkojmë falje, i mbështetemi Allahut nga të metat tona dhe nga të këqijat e veprave tona. Cilin e udhëzon Allahu, ai nuk humb kurrë, mirëpo cilin e humb Allahu, për të nuk ka udhëzues.

Përhëndesim dhe dërgojmë salavate për më të mirin e krijesave, më të zgjedhurin dhe më të ndriturin - robin e Allahut dhe të dërguarin e Tij - Muhamedin a.s.. Përhëndesim edhe familjen e tij të mirë dhe të pastër, shokët e tij të mirë dhe të pastër në përgjithësi, dhe ata të cilët i pasojnë gjurmët e tyre me mirësi deri në Ditën e Gjykimit.

Çështja e përqendrueshmërisë me llojet e saj është me rëndësi të posaçme për çdo pjesëtar të umetit, për t'ia kthyer umetit reputacionin, vlerën dhe krenarinë e tij, dhe të fitojë kundër armiqve të tij, që bota të udhëhiqet me mirësi dhe jetë të lumtur.

Për fat të keq, shumica e kanë humbur këtë veçori të mirë. Kështu shohim që disa përkohësisht falin namaz, largohen prej të këqijave dhe mëkateve, bëjnë punë të mira, kur befasisht shohim se largohen dhe çalojnë në adhurim ndaj Allahut, se shumë shpejt e humbin veçorinë e përqendrueshmërisë dhe durimit. Shumica e njerëzve janë falur rregullisht, e më vonë e kanë lënë.

Shumica e vajzave gjatë muajit të Ramazanit janë mbuluar me veshjen islame, ndërsa më vonë shohim se nuk e praktikojnë mbulesën.

Në start ndjenjat e muslimanëve janë në kulminacion, pastaj kohë pas kohe vjen deri te zbehja, përtacia dhe dështimi!!

Armiqtë e islamit këtë çështje e kanë kuptuar prej nesh, e kanë kuptuar se në start flakërohem,

pastaj i ftohim ndjenjat tona dhe ndaj neve veprojnë me këtë parim; në fillim na lirojnë të veprojmë çka të dëshirojmë deri sa ta shpenzojmë energjinë, pasi që t'i shpenzojmë emocionet e flakta të tona, ata veprojnë si të dëshirojnë me ne.

Pse e gjithë kjo zbrazëti?!

A nuk është e mundur që të mbulohet e gjithë kjo zbrazëti dhe të vazhdojë vullneti.

Atëherë kur vendin e kësaj zbrazëtie e zë vullneti dhe ndjenjat e forta të palëkundura jemi të përqendrueshëm.

Kur të flasim për qëndrueshmërinë në shoqëri, kemi për qëllim gjeneratën e artë të të parëve tanë, pra sehabët dhe ata të cilët e vazhdojnë rrugën e tyre me mirësi, dhe i përmbahen projektit të tyre deri në Ditën e Gjykimit.

Shpresojmë se Allahu do të na përqendrojë në fe, të na mundësojë t'i kryejmë obligimet, të largohemi prej mëkateve dhe të jemi të vendosur deri në fitoren e fesë dhe përhapjen e saj në botë, që të vendoset drejtësia, dhe të përkrahet e të largohet padrejtësia, e të mos përkrahet.

Shpresën e kemi vetëm te Ai, se në jemi të dobët, ndërsa Allahu është i fuqishëm dhe i pamposhtur, dhe vetëm Atij i mbështetemi, nuk ka mbrojtës më të mirë se Ai.

* * *

PËRQENDRUESHMËRIA NË NDIHMË TË FESË

Është çështje shumë e lehtë për të hyrë në shtëpinë e adhurimit, ashtu siç është çështje shumë e lehtë për të dalë nga shtëpia e mëkateve, ndërsa përqendrueshmëria është e vështirë. Ata të cilët dëshirojnë Iman të fortë dhe vullnet të fortë, bazë duhet të kenë përqendrueshmërinë.

Shembull: Kur zhvillohej lufta në Irak, deri sa forcat irakiane rezistonin kundër forcave okupatore, njerëzit kishin moral dhe iman të fortë, filluan ta adhuronin Allahun largoheshin prej mëkateve dhe punëve të këqija, mirëpo kur humbën shpresat në fitoren e muslimanëve dhe largimin e armikut, edhe pse shpresa vazhdonte, gjendja ndryshoi. Edhe pse njerëzit ishin falur natën, kishin falur sabahun rregullisht, kishin lexuar Kur'an, pasi që ishin lutur me përkushtim, pasi që ishin larguar nga ahengjet dhe dëfrimet etj., etj., pas gjithë kësaj ata prapë janë kthyer siç kanë qenë më parë. Kjo nga shkakut e humbjes së përqendrueshmërisë dhe pesimizmit.

لا حول ولا قوة إلا بالله

LA HAVLE VE LA KUVETE IL-LA BIL-LAH

Vëllezër!

Patjetër duhet të bëhemi të përqendrueshëm, pa vendosmëri nuk ka kurrfarë suksesi, ne kemi nevojë për përqendrueshmëri të vazhdueshme, ne kemi nevojë shumë që të largohemi prej mëkateve dhe pandërprerë t'i kryejmë obligimet. Ta kryejmë obligimin dhe të jemi të përqendrueshëm në mbrojtjen e Plestinës, Irakut dhe umetit në përgjithësi. Përqendrueshmëri në parimet themelore, në parimet e drejtësisë. Përqendrueshmëri para çështjeve të dyshimta, sprovave dhe epsheve.

Disa forma të paqëndrueshmërisë

- Kur të vjen muaji i bekuar i Ramazanit, shohim se si njerëzit i kthehen Zotit të Lartmadhëruar, ndërsa kur të kalon shohim se si ata prapë vazhdojnë me të vjetrën!
LA HAVLE VE LA KUVETE IL-LA BIL-LAH
- Shohim se si disa fillojnë t'i përmbahen fesë me plot ngazëllim dhe entuziazëm, mirëpo befasisht ndodhë diçka si:
 - Sillet keq me të ndonjëri prej fetarëve, e ai kthehet si ka qenë më parë, duke u arsyetuar se: Ja kështu të cekët janë të devotshmit.
 - Hynë në xhami, ndërsa para xhamisë i ka lënë këpucët e shtrenjta, mirëpo kur del prej xhamisë sheh se këpucët i janë vjedhur, e ai

kthehet prapë me të vjetrën, duke thënë:
Kurrë më nuk do të shkojë në xhami.

- Sheh diçka te të devotshmit që nuk i pëlqen, prapë kthehet me të vjetrën, duke thënë: Se kam kaluar një kohë në mesin e të devotshmëve, mirëpo e kam parë se si në tregti, si në veprimet e tjera nuk janë të sinqertë, nuk janë të përpiktë etj. etj.

Vëlla!

Nëse dëshiron shpëtim dhe përqendrueshmëri, mos i shiko të tjerët se si sillen me ty, por drejtoju Allahut të Lartmadhëruar me punë të mira dhe të qëndrueshme, nëse nuk vepron kështu, ta dish se shpinën ia ke kthyer Allahut të Lartmadhëruar dhe emrave të bekuar të Tij.

Vëlla!

Nëse të tjerët i merr për bazë për veprat e mira të tua, atëherë e ke humbur qëndrueshmërinë. Allahu i Lartmadhëruar thotë:

“Ka disa prej njerëzve që adhurojnë Allahun një anshëm (lëkundshëm). Nëse i bie mirë, e pranon dhe është i qetë në të, por nëse e kaplon ndonjë sprovim, menjëherë largohet dhe ia kthen shpinën fesë, kështu ai ka humbur edhe këtë botë, edhe botën tjetër, kjo është humbje e qartë”.

(El-Haxh, 11)

● Shohim se si disa i kryejnë detyrat, i kryejnë detyrat sepse prej Allahut dëshiron që t'i plotësohet ndonjë dëshirë, si p.sh. të kalojë në provime ose për t'u martuar me ndonjë vajzë, ose për ndonjë pasuri etj., etj. Kur t'ia plotësojë Allahu i Lartmadhëruar atë dëshirë kthehet me të vjetrën, në rrugën e humbur.

LA HAVLE VE LA KUVETE IL-LA BIL-LAH

- Shohim se si disa premtojnë se nëse Allahu do t'ia mundësojë t'i realizojë shpresat dhe dëshirat e tij, atëherë ai do ta adhurojë Allahun dhe nuk do të mëkaton, mirëpo edhe pse i realizohen dëshirat dhe shpresat, ai nuk e mban premtimin.

Këto janë disa prej formave të pavendosmërisë. Zoti i Lartmadhëruar thotë:

“Ka disa prej tyre të cilët i premtojnë Allahut, nëse na jep prej të mirave të Tij do të japim sadaka dhe do të jemi vërtet prej më të mirëve. E kur iu ka dhënë Allahu prej të mirave të Tij, janë bërë koprracë, e kanë kthyer shpinën dhe janë bërë prej të larguarve. Ata i ka kapluar dyfytirësia në zemrat e tyre dhe ashtu do të jenë deri kur ta takojnë Allahun, kur ta vërtetojnë se kanë tradhtuar, dhe nuk e kanë kryer premtimin e dhënë ndaj Allahut, dhe se kanë gënjyer. Po, a nuk e dinë se vërtet Allahu e di të fshehtën e tyre dhe pëshpëritjen e tyre. Vërtet Allahu është njohës i të fshehtëve”.

(Et-Tevbe, 75,78)

Vëlla!

Nëse dëshiron shpëtim, bëhu i vendosur në adhurim ndaj Allahut, e mos e lejo veten që t'i premtosh Allahut e pastaj të tradhtosh, sepse kjo është formë e labilitetit dhe humbjes së vendosmërisë.

- Shohim se si disa i drejtohen Allahut të Lartmadhëruar me seriozitet, ua mësojnë të tjerëve fenë e tyre, i udhëzojnë të tjerët në rrugën e Allahut, thërrasin në rrugën e Tij, e kur të torturohen dhe përjetojnë sprova nga të tjerët për veprimtarinë e tyre, aq shumë shmangen, aq shumë frikësohen, aq shumë izolohen, sa që të gjithë aktivitetin e tyre e ndërpresin.

Ashtu ndodhë kur ndonjë vajzë e re për shkak të mbulesës përjeton vështirësi në punën e saj ose ka mosmarrëveshje me burrin e saj, shumë shpejt e humb durimin, dorëzohet dhe e heq mbulesën, e nuk turpërohet. Kjo do të thotë humbje e vendosmërisë. Zoti i Lartmadhëruar thotë:

“Ka disa prej njerëzve të cilët thonë kemi besuar Allahun, por kur torturohen për shkak të rrugës së Allahut, ai barazon (balancon) sprovimin e njerëzve me dënimin e Allahut”.

(El-Ankebut, 10)

Vëlla!

Nëse dëshiron shpëtim bëhu i vendosur në adhurim ndaj Allahut, e mos e lejo veten që të largohesh nga adhurimi për shkak të torturimeve dhe nënçmimeve të tjerëve, sepse kjo do të thotë sterilitet dhe labilitet.

Shohim se si disa janë të devotshëm, mirëpo ai thotë se nuk e ka përjetuar ëmbëlsirën e imanit, nuk ndien përkushtim në namaz, nuk ndien ëmbëlsirë kur të këndojë Kur'an, nuk përjeton përforsim të imanit me agjërim dhe sadaka etj., etj. Kjo do të thotë labilitet.

Shohim se si disa ndiejnë plogështi dhe zbrazëti kur t'i kryejnë adhurimet ndaj Allahut ose kur të largohen prej mëkateve dhe nuk kanë interesim të madh në adhurim, nuk i drejtohen me përkushtim Allahut të Lartmadhëruar. Ndihen të dobët pse i janë “drejtuar” Zotit dhe se kanë filluar për t'u zhgënjyer me veten e tyre pse mësojnë, dhe i përmbahen fesë.

Zhgënjehen pasi që i përcjellin lajmet për muslimanët në Palestinë, në Irak dhe në vendet tjera islame, dhe nuk mund të durojnë vazhdimisht. Saktësisht kjo është labilitet dhe humbje e vendosmërisë.

Vëlla!!

A nuk e ke dëgjuar fjalën e Allahut të Lartmadhëruar:

“A ju e paskeni llogaritur se do të hyni në xhenet, pa iu ardhur juve (sprovimi) sikurse atyre para jush, kur i ka kapluar varfëria dhe vështirësia dhe aq shumë janë tronditur sa që i Dërguari thoshte, e me të edhe ata që kishin besuar: “Kur më, ndihma e Allahut?!” Po, me të vërtetë ndihma e Allahut është afër!”.

(El-Bekare, 214)

A nuk e ke dëgjuar fjalën e Allahut të Lartmadhëruar:

“A ju e paskeni llogaritur se do të hyni në xhenet, e pa e ditur Allahu se cili prej jush është angazhuar dhe ka luftuar në rrugën e Allahut, dhe duke i njohur durimtarët”.

(Ali Imran, 142)

Vëlla!!

Duro deri në vdekje, duro në adhurim ndaj Allahut deri në çastet e fundit të jetës.

- Shohim se si disa i drejtohen Allahut, mirëpo kur të jenë të angazhuar me çështjet e dunjasë, nuk brengosen pse bëjnë mëkate, ose i lëshojnë urdhrat e Allahut, bëhen indiferentë, nuk i interesojnë çka iu ndodhë muslimanëve dhe si torturohen e maltretohen ata. Ata martohen, shtohen linden fëmijë, i kthehen pasurisë, bashkëshorteve, fëmijëve. Saktësisht kjo është labiliteti dhe humbja e vendosmërisë.

Vëlla!!

A nuk e ke dëgjuar fjalën e Allahut të Lartmadhëruar:

“O ju të cilët keni besuar, ç’është me ju, që kur u thuhet: Dilni në (luftë) rrugën e Allahut”, ju u rënduat në vend dhe u ngulitët. A mos ishit më të kënaqur me jetën e kësaj bote se sa me botën tjetër? Përjetimi i kësaj bote në krahasim me botën tjetër është kënaqësi shumë e vogël”.

(Et-Tevbe, 38)

Vëlla!!

Këto janë disa prej formave të labilitetit, të gjitha i ka përmbledhur ajeti kur'anor, e pastaj tërheqë vërejtjen për të mos humbur vendosmërinë, ia tërheqë vërejtjen secilit: atij i cili fillon adhurimin, pastaj largohet, atij i cili një kohë ka qenë i devotshëm, e pastaj është larguar.

Zoti i Lartmadhëruar thotë:

“Mos u bëni sikurse ajo, e cila e ka prishur thurjen e saj, pasi që e ka thurur me forcë dhe mund të madh”.

(En-Nahl, 92)

Vëlla!!

Paramendo sikur një grua e cila thur rrobën me mund të madh, deri sa i afrohet përfundimit, kur befasisht në vend se ta vazhdojë thurjen, ajo fillon ta shthurë, deri sa e shthurë tërësisht dhe bëhet sikurse të mos kishte punuar asgjë! Ky ajet kur'anor ka kuptim të veçantë, i cili tregon pavendosmërinë me shembull të qartë dhe konkret.

MJETET E VENDOSMËRISË DERI NË VDEKJE

Pas hulumtimit nëpër libra dhe pas hulumtimit të ngjarjeve, dhe thënieve të të parëve tanë të devotshëm (selefu salih), kam hasur për secilin, i cili dëshiron të jetë i vendosur në fenë e Allahut, i cili dëshiron për t'u larguar prej mëkateve dhe dëshiron për t'i ndihmuar muslimanëve; për çdo njërin, i cili e dëshiron të drejtën dhe mbrojtjen e tij dhe nuk e dëshiron të padrejtën, dhe dëshiron ta largojë atë; kam hasur në mjetet e dobishme, të cilat ndihmojnë me ndihmën e Allahut, për atë i cili i përmbahet dhe dëshiron të jetë i vendosur në fenë e Allahut. Prej këtyre mjeteve po përmendim si vijon:

1. Kuptimi i islamit, kuptimplotë duke lexuar Kur'anin, duke e analizuar, studiuar atë dhe duke vepruar me të, po ashtu të vepruarit me sunetin e të Dërguarit të Allahut a.s..

2. Leximi i historisë të të parëve tanë të cilët kanë qenë të rrënjosur në fenë e Allahut, si: historia e pejgamberëve, biografia e Muhamedit a.s., historia e sehabëve, tabiinëve. Jeta e tyre duhet lexuar me vështrim, studim, analizë të thellë dhe duhet vepruar ashtu siç kanë vepruar ata, e jo vetëm lexim formal, apo si ndonjë libër me tregime.

Zoti i Lartmadhëruar thotë:

“Dhe Ne t’i tregojmë të gjitha lajmet për të Dërguarit me qëllim që ta forcojmë zemrën tënde”. (Hudë, 120)

3. Të përmendurit e Allahut xh.sh. pandërprerë, posaçërisht në mënyrën “LA ILAHE IL-LALLAH”. Ai i cili vdes, ndërsa zemra e tij nuk e ka ndier ëmbëlsirën e kësaj fjale dhe ka qenë e ngurosur, po ia përkujtojmë këtë hadithë:

Ebu Hurejtete r.a. transmeton nga Pejgamberi s.a.v.s. se ka thënë: Zoti i juaj ka thënë:

“Sikur robërit e Mi të më respektonin, do t’u zbritja shi natën, ndërsa dielli do t’i nxehte ditën, sa që edhe ushtimën e vetëtimës nuk do ta dëgjonin”.

I Dërguari i Allahut s.a.v.s. ka thënë:

“Forcojeni imanin. E kanë pyetur: O i Dërguar i Allahut, po si ta forcojmë imamin? Është përgjigjur: - Shpeshtojeni fjalën LA ILAHE IL-LALLAH”.

(“Musnedi imam Ahmedit”, 8353 dhe “Daifull xhamië” i Albanit)

4. Strukturimi i vetvetes me durim dhe të falurit vazhdimisht me xhematë. Nuk mund të ketë vendosmëri pa durim dhe namaz, sepse Zoti i Lartmadhëruar ka thënë:

“O ju të cilët keni besuar, përforcojeni veten dhe kërkoni mbrojtje e ndihmë me durim dhe namaz, vërtet Allahu është me durimtarët”.

(El-Bekare, 153)

5. Të vepruarit e veprave, të cilat afrojnë te Allahu dhe të larguarit nga ndalesat dhe të këqijat.
6. Lërja anash e krekosjes, pra mos u krekos me veten tënde se bën adhurim.
7. Të përkujtuarit e vdekjes dhe botës tjetër.
8. Të mbështeturit në Allahun e Lartmadhëruar, të luturit dhe adhurimi vetëm ndaj Tij.

Allahu i Lartmadhëruar thotë:

“Dhe sikur të mos të kishim përforcuar, për pak ishit duke iu mbështetur atyre për diçka fort pak”.

(El-Isra, 74)

Vëlla!

A dëshiron të jesh i devotshëm në atë çka ka urdhëruar Allahu i Lartmadhëruar deri sa të vdesësh?

A dëshiron të jesh i angazhuar për çështjen e islamit dhe muslimanëve deri në vdekje?

A dëshiron të jetë i dashur islami për ty deri sa të vdesësh?

A dëshiron të jesh i vendosur deri në vdekje në fjalën
LA ILAHE IL-LALLAH MUHAMEDUN RERULULLAH?

A dëshiron të jetosh për islamin dhe muslimanët deri në vdekje?

A dëshiron të jesh i vendosur dhe të pendohesh vazhdimisht deri në vdekje?

Mbështetu Allahut të Lartmadhëruar dhe kërko përkrahje për gjithçka që e kënaq Allahun e Lartmadhëruar dhe që e përforcon imanin te Ai.

Allahu i Lartmadhëruar thotë:

“Allahu forcon ata të cilët kanë besuar me fjalë të vendosura dhe të qëndrueshme në këtë botë dhe në botën tjetër. Allahu i humbë kriminelët dhe Allahu vepron çka të dëshirojë”.

(Ibrahim, 27)

“Dhe kur Zoti yt i frymëzoi melekët, dhe u tha se padyshim Unë jam me ju, pra përforconi dhe bëni të vendosur besimtarët, ndërsa në zemrat e pabesimtarëve do të shtijë frikë, e ju goditni mbi qafat e tyre, dhe goditni në çdo gisht të këmbëve e duarve të tyre”.

(El-Enfal, 12)

Aliu r.a. transmeton:

*“Më ka dërguar i Dërguari i Allahut gjykatës në Jemen. I kam thënë: - O i Dërguar i Allahut, më dërgon gjykatës, ndërsa unë jam i ri?! – I Dërguari i Allahut më tha: **“Pa dyshim, Zoti do ta udhëzojë zemrën tënde dhe do ta përforcojë gjuhën tënde. Nëse dy palë ulen pranë teje, mos gjyko pa e dëgjuar secilin prej tyre me vëmendje, sepse kjo ndihmon që të mos gabosh në vendimmarrje”.** Aliu r.a. ka thënë: **“Deri sa kam qenë gjykatës, asnjëherë askush nuk është ankuar në mua për çështje të gjyqësisë”.***

Vëlla!! Në vdekje nuk mund të të përforcojë askush, pos Allahut.

Në varr nuk mund të të përforcojë askush, pos Allahut.

Othman Ibn Afani r.a. ka thënë: Pasi që përfundonte varrimi i të vdekurit, Muhamedi a.s. qëndronte pranë varrit të të vdekurit dhe thoshte:

“Kërkoni falje për vëllanë tuaj që Zoti ta përforcojë, sepse tani ai jep llogari”.

Ebi Ala bin Shehir transmeton se një njeri prej pasardhësve të beni Handhaletes ka thënë: “Jam shoqëruar në një udhëtim me Shedad bin Evsin dhe më ka thënë: - A dëshiron të të mësoj atë që ma ka mësuar i Dërguari i Allahut për të thënë? Thuaj: “O Zoti im, të lutem më bën të vendosur në çështjet e mia, dëshiroj vendosmëri në udhëzimet e mia, të lutem më bën të jem mirënjohës ndaj Teje dhe të jem i sigurtë në adhurim. Të lutem ma bëj gjuhën e drejtë dhe zemrën e shëndoshë. O Zoti im! Kërkoj mbrojtje nga e keqja, të cilën Ti e di se do të më ndodhë mua, dhe të lutem për të mirat, të cilat Ti i di se do të jenë në mua. Kërkoj falje për ato gabime që i kam bërë e që Ti i di. Vërtet Ti je i Ditur dhe i di të fshehtat”.

*(“Suneni Tirmidhiut” 3329,
“Daiful xhamiu lil Albani”, 1190)*

Shehr bin Husheb transmeton se e ka pyetur Umi Selemeten: - Oj Nëna e besimtarëve! Cila ka qenë lutja më e shpeshtë e të Dërguarit të Allahut të Lartmadhëruar, deri sa ka qenë tek ti? - Ajo është përgjigjur: Lutja më e shpeshtë e tij ka qenë:

“O ndryshues i zemrave, përforcoje zemrën time në fenë Tënde”. Ka thënë ajo: pastaj e kam pyetur të Dërguarin e Allahut: - Cila është dua që më së shpeshti e thua? - Më është përgjigjur: “O ndryshues i zemrave, përforcoje zemrën time në fenë Tënde”.

- Më ka thënë: “Oj Umi Selemete! Çdo njeri është në mes të dy drejtimeve (gishtave) të Allahut: Cilin do e drejton dhe e përforcon, dhe cilin do e bën që të rrëshqasë”. Pastaj Muadhi e ka kënduar ajetin:

“O Zoti ynë, mos lejo që zemrat tona të rrëshqasin pasi që na ke udhëzuar në rrugë të drejtë”.

(Ali Imran, 8)

Vëlla!!

Për Zotin, nuk mund të përmirësohet asgjë në vetën tonë pa pasur mbështetje te Allahu i Lartmadhëruar. Për këtë arsye edhe nuk pranohet këndimi i suretul Fatiha pa e lexuar ajetin në mes:

“Vetëm Ty të adhurojmë dhe vetëm prej Teje ndihmë kërkojmë”.

Oj rini islame! O ju të cilët jeni fillestarë në Fe! O ju të cilët jeni të brengosur për çështjen e Palestinës, Irakurt dhe umetit në përgjithësi! O ju të cilët kërkoni që Allahu t'i ndihmojë islamit dhe t'i ngritë muslimanët - lutuni në sexhde: *“O Zot na përforco”*.

Rregull: Mbështetu Allahut

Kur kam qenë në haxh, shkuam në kodrën e Arafatit, numri i muslimanëve aty ishte 3 milion. Njerëzit ishin plot emocione dh gjërat i merrnin me vrull të madh për t'u ngjitur në kodër të Arafatit, e atje për t'iu lutur Allahut të Lartmadhëruar me përkushtim të plotë. Mirëpo, çka ndodhi?

Kur arritëm lart në Kodër, tentuam të lutemi, por kot, nuk mundëm, pse disa prej nesh i kaploi përtacia, të tjerët kotja, disa të tjerë i humbën ndjenjat e duasë në atë shkallë sa që njerëzit më nuk kishin ambicie, dhe kështu ata kalonin aty me biseda të rëndomta.

E gjithë kjo ka ndodhur për arsye se ata kishin menduar se do të ishin në gjendje për tu lutur, mirëpo me kalimin e kohës e kuptuan se kanë nevojë për mbështetje tek Allahu për t'u lutur.

Në fillim njerëzit menduan se kanë aftësi vetë t'i kryejnë lutjet, mirëpo dështuan, e pastaj iu mbështetën vetëm Allahut Një dhe u përforcuan. Allahu përkrahë dhe ndihmon ata të cilët i përkushtohen dhe i luten Atij.

Vëllezër!!

Çështja e lutjes “*O Zot më ndihmo*” duhet të zë vend meritë në zemrat tona; kërkon ndihmë prej Allahut se Ai është ndihmëtar i miri.

9. Shoqërimi me të mirët

Nëse dëshiron vendosmëri, m’i trego shokët e tu, e tek pastaj të tregoj se a mundesh të jesh i vendosur apo jo! Nëse ende i ke ata shokë pranë, ndërsa ata janë larg Allahut, ta dish se ti dështon, ti do të hidhërohesh edhe me babën, edhe me nënën tënde, sepse ata vazhdimisht insistojnë që ti të largohesh nga ky shok dhe ai shok. Për Allahun Një, që nuk ka Zot pos Tij, nuk mund të jesh i vendosur dhe nuk mund ta adhurosh Allahun me përkushtim dhe nuk do të largohesh prej mëkateve deri sa të largohesh nga ata shokë të këqij.

Më thuaj, cilët janë shokët tu që të tregoj ty se *a mund të pendohesh apo jo!*

Zoti i Lartmadhëruar thotë:

“Pasha kohën! Nuk ka dyshim se njeriu është i humbur, përpos atyre që besojnë, bëjnë vepra të mira, që porositin dhe e këshillojnë njëri-tjetrin për drejtësi, dhe porositin dhe e këshillojnë njëri-tjetrin për durim”.

(El-Asr, 1-4)

Imam Shafiu r.a. thotë:

“Po mos të kishte pasur në Kur'an sure tjetër pos kësaj sureje, do t'u mjaftonte njerëzve, pse në të ka porosi për durim dhe porosi për drejtësi”.

Të gjithë njerëzit janë në humbje pos atyre që porositin në drejtësi dhe durim. Shoqërimi me të mirët ka rëndësi të madhe. Nuk ka shpresë për vendosmëri, përpos përmes shoqërimit me të mirët. Zoti i Lartmadhëruar thotë:

“Dhe përkufizojë veten e bëhu i durueshëm me ata të cilët e lusin Zotin e tyre ditë e natë dhe dëshirojnë kënaqësinë e Tij (e Allahut), e mos lejo që të largohet shikimi yt nga ata për kërkim të bukurisë së kësaj bote. Dhe mos dëgjo atë të cilit zemrën ia kemi mbyllur e është larguar nga përkujtimi ndaj Nesh dhe i pason epshet e tij, pse puna e tij ka mbaruar”.

(El-Kehf, 28)

Vëlla!!

Nëse ti largohesh prej atyre, të cilët e lusin Allahun ditë e natë, do të fundosesh në detin e epsheve dhe kënaqësive të kësaj bote.

Vëlla!!

Hulumto për shoqëri të mirë, për shoqëri, e cila i përmbahet litarit të Allahut. Hulumto për ata të cilët i përmbahen sunetit të Pejgamberit s.a.v.s.. Hulumto për ata, të cilët kapen për fenë e tyre, të vendosur në

përkushtim ndaj Zotit të tyre, të larguar prej mëkateve. Hulumto për shokë të tillë që të gjithë së bashku t'i ndihmoni njëri-tjetrit në adhurim ndaj Allahut të Lartmadhëruar, ta porositni njëri-tjetrin për drejtësi dhe për durim. Ata i takon në xhami, në vendet ku lexohet Kur'ani, i takon në kuvendime të diturisë.

Shoqërimi me të mirët është ajo çka të bën të vendosur në adhurim ndaj Allahut të Lartmadhëruar dhe largim nga mëkatet, ndërsa shoqërimi me kriminelë është humbje dhe dështim.

Argument:

Ishte një njeri i cili quhej Ukbe bin Ebi Muitë, i cili ishte pabesimtar. Ai e ka nënçmuar Pejgamberin s.a.v.s. shumë dhe është vrarë si pabesimtarë në Bedër.

Ky njeri gati sa nuk e kishte pranuar islamin, mirëpo e kishte një shok të shpirtit, e ai ishte Ebu Xhehli, i cili e ka marrë atë çka e ka merituar. Ky e ka penguar për të mos e pranuar islamin, për këtë arsye ka vdekur pabesimtar.

Një ditë Ukbe shkon te Ebu Xhehli dhe i tregon se i ka lënë shumë përshtypje të mirë Muhamedi a.s., mirëpo Ebu Xhehli e kërcënon me ndërprerje të lidhjeve shoqërore, përpos kësaj kërkon nga ai që të shkonte te Muhamedi a.s. dhe ta pështynte në fytyrë. Para tij ishin dy çështje: Ose Ebu Xhehlin, ose pranimin e islamit, mirëpo anoi

shoqërimi me Ebu Xhehlin dhe nuk e pranoi islamin, kështu që e dëgjoi atë çka i tha Ebu Xhehli, për këtë arsye edhe vdes pabesimtar. Pra, ky ishte rezultati i shoqërimit me të keqin.

Zoti i Lartmadhëruar thotë:

“Atë ditë kur kriminelin do t’i kafshojë duart e tij duke thënë: O i mjeri unë, po sikur ta kisha marrë rrugën me të Dërguarin. I mjeri unë po sikur mos ta kisha dëgjuar dhe mos të isha shok me filanin (N.N.)”.

(El-Furkan, 27, 28)

10. Shërbimi për islamin dhe fitoren e tij

Zoti i Lartmadhëruar thotë:

“Nëse i ndihmoni Allahut, Allahu do t’u ndihmojë juve dhe do t’u përforcojë këmbët (zemrat) e juaja”.

(Muhamed, 7)

Nëse dëshiron që Allahu t’i përforcojë këmbët e tua në adhurim ndaj Tij dhe të largohesh nga mëkatet, vepro diçka për Të, për fenë e Tij, bëhu ndihmëtar i fesë së Tij, dhe thirr në rrugën e Tij. Këto janë çështje praktike, mundohuni që të filloni që nga sot. Puna jote për islamin bën që islami të jetë preokupimi kryesor për ty.

Psikologët thonë: Mendja posedon dy vende, njëri vend është vendi ku njeriu është i kënaqur me atë që e posedon, mirëpo përballë saj është vendi i epsheve, i cili nuk ngopet dhe nuk kënaqet.

Është e mundur që te ju të jetë ndjenja ku islami është feja dhe çështja më e çmuar për ty. Çështja e Palestinës është çështje me rëndësi, mirëpo për fat të keq ajo ndjenjë nuk rritet. Si të ndodhë që çështja e karakterit të jetë çështje, e cila rritet tek ti, që ti të veprosh për ato norma të karakterit dhe që ato të jenë efektive.

Allahu i Lartmadhëruar thotë:

“Ju jeni populli më i mirë, i zgjedhur (seleksionuar) për të mirën e njerëzve, sepse ju urdhëroni në punë të mira (njerëzimin) dhe parandaloni nga të këqijat (njerëzimin) dhe besoni në Allahun”.

(Ali Imran, 110)

Çështja më e vlefshme në këtë botë është që ti të veprosh për Allahun, fenë e tij, e cila është më e çmuara dhe nuk ka fe tjetër, pos saj.

Vëlla!!

Thirr në rrugën e Allahut. Bashkëngjitu xhamisë ku lexohet Kur’ani. Shpërndaj kaseta dhe libra islame për të kryer detyrën e thirrjes në rrugën e Allahut të Lartmadhëruar. Mëso texhvidin dhe mësoja të tjerëve, përfito dituri dhe mëso të tjerët. Themelo shoqatë të jetimëve. Thirr për kontribut ndaj jetimëve. Hape “Web sidin” në internet ku i ndihmon islamit. Themelo shoqatë bamirëse. Shfrytëzoje përvojën dhe aftësinë tënde në shërbim të islamit.

11. Leximi i Kur'anit, analizimi dhe studimi në të , po ashtu të vepruarit me të

Që të jesh i vendosur lexo Kur'an për çdo ditë, tento që për çdo muaj të përfundosh një hatme, që zemra jote të gjallërohet me Kur'an. Provo të mësosh përmendësh prej Kur'anit, deri sa zemra jote të lulëzojë dhe të forcohet.

Ibn Abasi transmeton se i Dërguari i Allahut s.a.v.s. ka thënë:

“Ai, i cili në brendi (mendje) të tij nuk ka asgjë prej Kur'anit ai është si një shtëpi e prishur”.

(“Suneni i Tirmidhiut”, 2837. Tirmidhiu ka thënë ky hadithë është Hasen Sahihë)

Vëlla!!

Mëso rregullat e texhvidit dhe lexo Kur'anin rrjedhshëm. Është e palogjikshme që t'i mësosh gjuhët e huaja, ndërsa nuk mundesh të lexosh librin (Kur'anin) e Zotit të Lartmadhëruar.

Po ashtu lexo komentimet e Kur'anit që ta përjetosh ëmbëlsirën e Imanit.

12. Bilalli r.a. transmeton se Muhamdi a.s. ka thënë:

“Falni Namaze të natës, sepse ky është veprim i të mirëve para jush, sepse namazi i natës është afrim te Allahu dhe asimilim i të këqijave (largim i sëmundjes nga trupi)”

(Suneni i Tirmidhiut, “Sahih xhamiu lil Albani” [Daif el-xhamiu lil Albani])

Ebu Umamete r.a. transmeton se Muhamedi a.s. ka thënë:

“Falni namaze të natës, sepse është veprim i të mirëve para jush, afrim te Zoti i juaj dhe asgjësim i të këqijave dhe përfundim i mëkateve”.

(Suneni i Tirmidhiut, 3472)

Ky hadith është më i vërtetë se hadithi i Ebi Idrizit nga Bilalli.

PËRFUNDIM

Në fund të këtij mesazhi, lusim Allahun që t'i bëjë dobi çdo lexuesi të këtij libri, ashtu siç e lusim Allahun që të na pranojë prej veprave të mira, të na vendosë veprat tona në vagën e punëve të mira, e të na fshijë nga vaga e të këqijave dhe lajthitjeve, ashtu siç e lusim Allahu të na falë mëkatet, lajthitjet dhe rrëshqitjet. Ajo çka është e qëlluar është prej asaj çka na ka mësuar Allahu dhe i Dërguari i Tij, ajo çka është lajthitje, lëshim, harresë është nga unë dhe prej shejtanit. Allahu i Lartmadhëruar është i pastër nga ajo. Lus Allahun për falje, fshehje të lëshimeve, mëkateve për mua dhe për lexuesit.

Në fund:

Të lusim Allahun të gjithë së bashku me këtë dua, me shpresë se Allahu do të na pranojë dhe të jetë arsye për të na forcuar për të vërtetën, dhe për të na ndihmuar për të lënë të keqen, dhe për t'u larguar prej saj, që të jetë arsye që të jemi të përqendruar në fenë e Tij, të jemi të përkushtuar në ndihmën e islamit dhe muslimanëve, largimin prej mëkateve, dhe eliminimin e brengave, dhe pikëllimin e muslimanëve, e fesë islame në përgjithësi.

JA DHE XHELALI VEL IKRAM, JA DHEL XHELALI VEL IKRAM!

O zoti ynë, ne jemi umeti i të dashurit tënd Muhamedit s.a.v.s. Ti je mbrojtësi ynë dhe Ti je mbrojtësi më i miri.

Vetëm Ti na mjafton për brengat tona. Nuk kemi kujt t'i drejtohemi pos Teje. Ti je Sunduesi absolut. Ti je i Gjalli i Përgjithmonshëm. Ti i ke në kompetencë dhe nën sundim çdo gjë, vepron çka do dhe çka dëshiron. O Sundimtar i të gjithëve, Ti i jep pushtet kujt do dhe e zbrit nga pushteti cilin do, e ngritë cilën do dhe e poshtëron cilin do. Ti i ke në dorë të gjitha të mirat, Ti ke mundësi për çdo send. Ti e zgjatë dorën natën, për t'u penduar gabimtari i ditës, dhe Ti e zgjatë dorën ditën, për t'u penduar gabimtari i natës.

Ti gëzohesh me pendimin e robit tënd. O i Gjallë i Përgjithmonshëm! JA HANNAN JA MENNAN, JA HANNAN JA MENNAN , umeti i Muhamedit kërkon ndihmë te Ti, o Zot i tokës dhe i qiejve. Na ka kapluar rreziku, ndërsa Ti je më i mëshirshmi i të gjithë mëshiruesve. O Zoti ynë, jemi mundur, na ndihmo me fitore. Zoti ynë, ne jemi të dobët, nuk kemi Zot tjetër pos Teje. Kërkojmë prej Teje, o Sundimtar i të gjithëve. Kërkojmë të na falësh mëkatet tona. Na fal se s'kemi Zot pos Teje, gabimet nuk i falë askush pos Teje. Ne jemi të dobët dhe të pafuqishëm, modest dhe të thjeshtë, ne jemi të dobët në vetvete dhe ndaj tjerëve, dobësia në ne na bën që të bëjmë gabime dhe të digjemi ne zjarr. Kërkojmë mbrojtje tek Ti prej epshit tonë, të këqijave tona, mëkateve tona dhe ngatërresave tona. Kërkojmë mbrojtje nga mëkatet dhe Xhehenemi. Të lutemi na fal Xhenetin dhe vendet më të mira. Ti je Zot i të gjithë botëve, Ti je Zot i të

dobëtëve, Ti je Zoti ynë. Ne dëshirojmë vetëm kënaqësinë Tënde ndaj neve, e jo hidhërimin. Për hir të madhërisë Tënde, që me dritën Tënde shndritë dhe i fshin të gjitha errësirat dhe i sjellë të gjitha të mirat e kësaj bote dhe të botës tjetër, largoje hidhërimin Tënd nga ne, largoje zemërimin Tënd nga ne. Kërkojmë vetëm kënaqësinë Tënde, nuk ka forcë as fuqi e cila mund të ndryshojë diçka pos Teje, Ti je një - Mbrojtësi dhe Ndihmësi ynë. JA DHEL XHELALI VEL IKRAM, JA HANNAN JA MENNAN, ndihmo vëllezërit tanë në Palestinë, Irak dhe çdo vend Islam.

O Zot, mbroji vëllezërit tanë, O Zot mbrona neve nga mëkatet tona, mbrona nga zullumqarët, nga shejtani dhe nga tradhtarët!

O Zot, pranoje këtë lutje, o Zot pranoje këtë lutje!

O Zot, dërgoje këtë përshëndetje për zotëriun tonë – Muhamedin a.s. familjen e tij, shokët e tij dhe kush i pason ata deri në Ditën e Gjykimit! Lutja e fundit përfundimtare:

FALËNDEROJMË ALLAHUN ZOTIN E GJITHË BOTËVE!

* * *

LIBRAT E AUTORIT (Dr. Musli Vërbanit)

1. “Besimi në Zotin”
2. “Melaqet e Zotit”
3. “Besimi në Librat e Zotit”
4. “Pejgamberët e Zotit”
5. “Besimi në Ditën e Kijametit”
6. “Besimi në Kaderin e Zotit”
7. “Tregime nga jeta e Muhamedit a.s.”
8. “Fikhu i Namazit”
9. “Fikhu i Zekatit”
10. “Fikhu i Agjërit”
11. “Fikhu i Haxhit”
12. “Emërtoni fëmijët tuaj me emra të bukur”
13. “Dëshmorët e 9 Prillit në Rakoc dhe Lagje të Re”
14. “Shkruaj, lexo dhe mëso shkronjat e Kur'anit
15. “Nata e dhëndërisë”
16. “Fadil Çaka – Komandant Sharri”
17. “Dita e vdekjes dhe e varrimit”.
18. “(Pa)mundësia e përkthimit të Kur'anit”.

PËRKTHIMET NGA GJUHA ARABE

1. “Këshilltari fisnik për djem dhe vajza” (*Muhamed Sajim*)
2. “Islami dhe Politika” (*nga autori Jusuf Kardavi*)
3. “Mrekullitë numerike në Kur'anin Fisnik” (*Abdurrezak Nufel*)
4. “Për Kushtetutën Islame” (*Dr. Muhamed Sejid Ahmed El Musejer*)
5. “Kryesore në terminologjinë e Hadithit” (*Abduhu Abas El-Velidi*)
6. “Vlera e kohës” (*nga autori Amër Halid*)
7. “Vëllazëria muslimane” (*nga autori Amër Halid*)
8. “Vëllazëria në islam dhe zemra e shëndoshë” (*Amër Halid*)
9. “Pendimi” (*nga autori Amër Halid*)
10. “Pasojat e mëkateve” (*nga autori Amër Halid*)
11. “Vendosmëria në fenë e Allahut” (*nga autori Amër Halid*)
12. “Mjetet e vendosmërisë në fenë e Allahut” (*nga Amër Halid*)

Së shpejti do të dalin nga shtypi përkthimet nga Amër Halidi:

1. “Forca në Allahun;
2. “Shpresa”;
3. “Besimi dhe bindja e fortë në Allahun”;
4. “Shpresa Imani dhe veprimi”;
5. “Serioziteti” dhe
6. “Pozitiviteti”.